

Tirane, me 23 Tetor 2014

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE TREGTARE “Security Solution & Distribution (SSD)” sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligji:

- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

1. Emiljano FETAHU, i biri i Kujtim dhe i Merrjeme, I dtl. 18 Qershor 1979 banues ne Tirane ,sheshi Karl Topia , kulla 2 Ap 9, pallati i Trema Engineering.
2. Migen KASAJ, , i biri i Luan dhe i Elida, I dtl. 07 Maj 1980 banues ne Tirane , bulevardi GjergjFishta , prane gjykates , nd 30 h 18 Ap 2.

krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**Security Solution & Distribution (SSD)” sh.p.k** me akt themelimi si me poshte vijon :

#### Formimi

##### Neni 1

Sot, me date 23 TETOR 2014, formohet shoqeria tregtare private e quajtur “**Security Solution & Distribution (SSD)”** (Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar). Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

#### Selia e Shoqerise

##### Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private “**Security Solution & Distribution (SSD)”** do te jete ne adresen: Tirane, Bulevardi Gjergj Fishta, pallati i shoqerise Gora i ndertuar ne zonen kadastrale Nr 8250 ne token me Nr pasurie te rregj ne hipoteke Nr 273 dt 26.01.1995, ,kati II ,ap 2.

## Objekti I Veprimtarise

### Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

**Tregetise me shumice dhe pakice te pajisjeve elektrike dhe elektronike, sistemeve te telekomunikacionit, sistemeve te survejimit dhe sherbimeve te tjera te ngjashme.**

Import-eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te mobiljeve dhe orendive, Import - eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te mallrave dhe pajisjeve industriale, ushqimore, bujqesore, blektorale, fruta-perime, materiale te ndertimit, lende te para, parfumeri, kozmetike etj. Tregetim te artikujve te kancelarise materialeve e pajisjeve per zyra, pajisje elektrike, elektronike, higjenosanitare, duraluminit, pllakave te gjitha llojeve, plastikes, gomes, lendes drusore e mobiljeve, hapjen e bar restoranteve, parukeri, si dhe cdo veprimtari tjetere tregetare qe permbush qellimin e hapjes se kesaj shoqerie. Shoqeria do te operoje ne fushen e ndertimit, si ndertimi i apartamenteve te banimit, ndertimeve publike, qendra tregetare , objekteve te kultit . Gjithashtu objekt i shoqerise do te jene edhe punimet ne fushen e ndertimit sic jane instalimet elektrike, instalimet hidraulike, dhe punime e sherbime te tjera ne fushen e ndertimit . Prodhime dhe tregetim te artikujve ushqimore dhe industriale.

## Kohezgjatja e Shoqerise

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar me shume se 10-vjecar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe percardo lloj shkaku me ane te vendimit te asamblese se ortakeve.

## Kapitali I Shoqerise

### Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 10,000,000 (dhjete milion ) Leke i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaket.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 10,000 (dhjetemije) kuota me vlere nominale 1,000 (njemije) leke te cilat zoterohen nga ortaket si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Emiljano Fetahu	5,000	5,000,000	50
Migen Kasaj	5,000	5,000,000	50
<b>Total</b>	<b>10,000</b>	<b>10,000,000</b>	<b>100</b>

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

## **Asambleja e Ortakeve**

### **Neni 6**

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte marrjes se vendimeve ne shoqeri. Ky organ perbehet nga ortaket themelues te kompanise. Ajo emerone ose shkarkone administratorin e shoqerise dhe administrator te tjere te vlerave materiale si dhe likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

## **Administratori**

### **Neni 7**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet ne veprimatrine e saj te perditeshem nga **Z. Emiljano Fetahu** i cili vepron si administrator ne respektim te legjislacionit perkates.

Administratori kryen gjate veprimterise se tij ato detyra qe ai i gjykon te nevojshme qe jane ne interes te shoqerise per realizimin e objektivit te shoqerise dhe sigurimit te fitimit. Te drejtat, detyrimet dhe kufizimet e administratorit jane pershkruar ne statutin e shoqeriss.

Administratori nuk mund te kryeje vetem ato kompetenca qe jane percaktuar si ekskluzive te Asamblese se Ortakeve.

Ne veprimatrine e tij administratori eshte i detyruar te dokumentoje hollesisht veprimtarine.

## **Veprimtaria Ekonomiko-Financiar**

### **Neni 8**

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lek. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, pervec rasteve urdhrave te vecante qe jepen nga asambleja e ortakeve. Ne fund te periudhes ushtrimore nxiren pasqyrat e gjendjes financiare te shoqerise (bilanci) dhe rezultati ekonomik (fitim/humbja) bazuar ne rregullat e mbajtjes se se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiscal.

## Fitimi/Humbja

### Neni 9

Fitimi, percaktimi dhe miratimi i tij behet nga asambleja e cila pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se tij percakton dhe pjesen e sejcilit. Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat per rezervat e nevojshme si dhe i jane zbritur ose shtuar humbje/fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Te punesuarit nuk marin pjese ne ndarjen e fitimit dhe nuk eshte e nevojshme te informohen per madhesine e tij.

Akti i themelimit u perpilua ne 3 (tre) kopje me vlere te barabarte, per t'ju shperndare organeve kompetente, ortakeve dhe mbajtje ne dokumentacionin baze te shoqerise "Security Solution & Distribution (SSD)" Sh.p.k

---

Ky dokument perbeht nga 9 (nente) nene ne 4 (kater) faqe

---

**Themeluesit e shoqerise tregtare "Security Solution & Distribution (SSD)"**

**Emiljano FETAHU**



**Migen KASAJ**



**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Security Solution & Distribution (SSD)” sh.p.k**

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjiet:

- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- -Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”;
- -Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqeria eshte krijuar nga themelueset dhe ortakët Si me poshte :

1. **Emiljano FETAHU**, i biri i Kujtim dhe i Merrjeme, I dtl. 18 Qershor 1979 banues ne Tirane , sheshi Karl Topia , kulla 2 Ap 9, pallati i Trema Engineering.
2. **Migen KASAJ**, , i biri i Luan dhe i Elida, I dtl. 07 Maj 1980 banues ne Tirane ,bulevardi GjergjFishta , prane gjykates , nd 30 h 18 Ap 2.

**Neni 2**

**Statusi**

Shoqeria e themeluar eshte person juridik dhe eshte **“shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”**

**Neni 3**

**Emri**

Shoqeria eshte emertuar **“Security Solution & Distribution (SSD)”**. Emri i saj pasqyrohet ne dokumentacionin e shoqerise si dhe ne vulen qe pason nenshkrimin e saj. Shkurtimi i emrit te rregjistruar **“Security Solution & Distribution ” do te jete “ SSD “** e cila do te sherbeje dhe si shenje apo iniciale dalluese e shoqerise ne ushtrimin e aktivitetit te saj tregetar.

#### Neni 4

##### Selia

Shoqeria "Security Solution & Distribution (SSD)" sh.p.k. ka si qender te veprimtarise se saj qytetin e Tiranes. Adresa e saj eshte "Tirane, Bulevardi Gjergj Fishta, pallati i shoqerise Gora i ndertuar ne zonen kadastrale Nr 8250 ne token me Nr pasurie te rregj ne hipoteke Nr 273 dt 26.01.1995, ,kati II ,ap 2.

Ajo e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Rrepublikes se Shqiperise. Selia ligjore e saj eshte dhe selia e organeve drejtuese te saj.

**Kohezgjatje eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar mbi 10 vjet.**

#### Neni 5

##### Qellimi i Shoqerise

Ne themelimin e kesaj shoqerie, ortaket jane nisur nga qellimi per te krijuar nje ndermarje nepermjet kontributeve pasurorore dhe profesionale, te cila jane ne gjendje te realizoje objektivat e percaktuara si objekt i veprimtarise se saj, ne forme aktiviteti ekonomik dhe biznesi, per te nxjerre fitime.

#### Neni 6

##### Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

**Tregetise me shumice dhe pakice te pajisjeve elektrike dhe elektronike, sistemeve te telekomunikacionit, sistemeve te survejimit dhe sherbimeve te tjera te ngjashme..**

Import-eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te mobiljeve dhe orendive, Import - eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te mallrave dhe pajisjeve industriale, ushqimore, bujqesore, blektorale, fruta-perime, materiale te ndertimit, lende te para, parfumeri, kozmetike etj. Tregetim te artikujve te kancelarise materialeve e pajisjeve per zyra, pajisje elektrike, elektronike, higjenosanitare, duraluminit, pllakave te te gjitha llojeve, plastikes, gomes, lendes drusore e mobiljeve, hapjen e bar restoranteve, parukeri, si dhe cdo veprimtari tjetër tregetare qe permbush qellimin e hapjes se kesaj shoqerie. Shoqeria do te operoje ne fushen e ndertimit, si ndertimi i apartamenteve te banimit, ndertimeve publike, qendra tregetare , objekteve te kultit . Gjithashtu objekt i shoqerise do te jene edhe punimet ne fushen e ndertimit sic jane instalimet elektrike, instalimet hidraulike, dhe punime e sherbime te tjera ne fushen e ndertimit . Prodhime dhe tregetim te artikujve ushqimore dhe industriale.



## Neni 7

### Vula

Shoqeria ka vulen e vet te identifikimit, e cila perdoret perbri nenshkrimet te Administratorit, ortakeve si dhe te punesuarve te autorizuar prej tij. Ajo perdoret vetem per probleme dhe qellime qe kane te bejne me shoqerine.

Vula do te hartohet pas marrjes se numrit NUIS i cili do te jete pjese integrale e vules.

## Neni 8

### Mardheniet me Persona Juridik e Fizik

Shoqeria eshte e lire dhe gezon te drejten te hyje ne marredhenie me persona fizik dhe juridik, shteteror ose privat, vendas ose te huaj per pjese te veprimtarise dhe per te gjitha veprimtarine, ose per pjesemarrje ne kapital te perbashket.

Pasqyrimi i ketyre mardhenieve behet duke respektuar kerkesat e ligjit shqipetar ne fuqi per keto ceshtje. Per keto mardhenie te shoqerise me personin juridik ose fizik te huaj nuk kerkohet autorizim paraprak nga organet e caktuara shteterore.

## Neni 9

### Personi Juridik dhe Zotesia per te Vepruar

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar ne fushat qe perbejne objektin e punes se saj vetem pas rregjistrimit prane QKR (Qendra Kombetare e Rregjistrimit) dhe organeve tatimore ku shoqeria ka seline.

## Neni 10

### Kapitali Shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte 10,000,000 (dhjete milion ) leke i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortakët.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 10,000 (dhjetemije) kuota me vlere nominale 1,000 (njemije) leke te cilat zoterohen nga ortakët si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Emiljano Fetahu	5,000	5,000,000	50
Migen Kasaj	5,000	5,000,000	50
<b>Total</b>	<b>10,000</b>	<b>10,000,000</b>	<b>100</b>

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

## **Neni 11**

### **Modalitetet e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit**

Madhesia e kapitalit themeltar, raportet e tij ne para e ne natyre, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, transferimi i kapitalit dhe probleme ne lidhje me te, do te realizohen sipas percaktimeve te bera ne Statutin e Shoqerise dhe ne ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare" dhe Kodin Civil te republikes se Shqiperise.

## **Neni 12**

### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, e drejta e parablerjes.**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme sipas percaktimeve te Kodit Civil.

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të

fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, por kjo gjithmone me miratimin e Asamblese se ortake.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet behet me miratimin e asamblese se ortakeve qe zoterojen shumicen e pjeseve te kapitalit themeltar dhe vetem pasi te gjithë ortakët kane dhene pergjigje me shkrim se nuk duan t'i blejne.

Ne kete rast vleresimi i pjeseve mund te behet edhe dhe me eksperte.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- Transferimi per cfaredo arsyeje, teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit te Shoqerise eshte subjekt i se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte ne raport me pjeset e tyre te kapitalit, brenda 30 (tridhjete) ditesh nga marrja e njoftimit te derguar me leter rekomande. Ne kete njoftim duhet te saktësohet cmimi i kerkuar, i cili duhet te



jete i arsyeshem dhe i njejte me ate qe do ti ofrohet nje personi te trete, jashte shoqerise. Ne rast se ortakët e tjere nuk pergjigjen brenda afatit te parashikuar, konsiderohet se ata kane hequr dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes.

- Ne rast se njeri prej ortakëve refuzon ose heq dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes, ortakët e tjere, te cilet tashme kane ushtruar te drejten e tyre te parablerjes, mund ta riperdorin kete te drejte edhe per pjesen e ofruar ortakut qe e refuzoi ate.
- Ne rast se me shume se nje ortak deshiron te riperdore te drejten e parablerjes, pjeset e kapitalit te ofruara ortakut qe nuk deshiron te ushtronte te drejten e tij, ndahen proporcionalisht me pjeset e kapitalit respektiv.
- Ne rast se vetem njeri prej ortakëve deshiron ta ushtroje te drejten e parablerjes, pjesa e kapitalit te ofruar i trasferohet atij teresisht ose ne ate mase qe ky ortak deshiron.
- Per kete qellim, ortakët qe deshirojne te riperdorin te drejten e tyre te parablerjes duhet te njoftojne vendimin e tyre ortakut qe deshiron te trasferoje pjeset e tij te kapitalit brenda 15 (pesembedhjete) ditesh qe prej marrjes se lajmit per mos ushtrimin e te drejtes se parablerjes prej ndonjerit prej ortakëve.
- Te gjitha njoftimet e siperpermendura do te behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit te Shoqerise

### **Neni 13**

#### **E drejta per informim dhe miratim i llogarive**

Administratori harton dokumentacionin perkates qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise:

- Raporti i administrimit
- Inventaret e shoqerise
- Llogarite vjetore te shoqerise

Inventari dhe llogarite vjetore hartohen konform kerkesave te ligjit "Per Kontabilitetin". Kur eshte e nevojshme pergatitet raporti I Eksperteve Kontabel.

Shkelja e te drejtes per informim e ben veprimin te pavlefshem. Raporti i administrimit pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarine e rendesishme te reaizuara e te mbyllura etj.

### **Neni 14**

#### **Viti Ushtrimor, Bilanci (Pasqyra e Gjendjes Financiare)**

Viti ushtrimor dhe bilanci i shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti. Bilanci ushtrimor dhe llogarite vjetore pergatiten duke respektuar kerkesat ligjore te legjislacionit perkates.

### **Neni 15**

#### **Fitimi**

Fitimi, percaktimi dhe miratimi i tij behet nga asambleja e cila pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se tij percakton dhe pjesen e seicilit. Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit :

1. I janë zbritur shumat për rezervat e nevojshme.
2. I janë zbritur ose shtuar humbje/fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Te punësuarit nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit dhe nuk informohen për madhësinë e tij.

#### **Neni 16**

##### **Rezervat**

Shoqëria nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi janë zbritur humbjet e vitit të kaluar kur ka të tilla, krijon rezervat e nevojshme për mbarevijimin e aktivitetit që ajo zhvillon.

#### **Neni 17**

##### **Organet Drejtuese**

Organet drejtuese të shoqërisë janë dy, Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Përberja e këtyre organeve përcaktohet në akt themelimit.

#### **Neni 18**

##### **Asambleja e Ortakëve**

Asambleja është me i larti organi vendimor i SH.P.K e cila përbehet nga të gjithë ortakët.

Asambleja mbledhet në selinë e shoqërisë sa herë gjykon të nevojshme ose kur kërkohet nga shumica e ortakëve. Ajo thirret nga organi administrativ që përgatit dhe dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes. Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga një i tret me autorizimin përkatës me shkrim të noterizuar.

Vendimet në asamble merren me shumicë votash të përcaktuara nga ata që kanë numerin më të madh të pjesëve të kapitalit.

Për sa i përket mbledhjes mbahet protokoll që nënshkruhet nga të pranishmit. Për administrimin dhe ruajtjen e tij mban përgjegjësi administratori.

#### **Neni 19**

##### **Kompetencat e Asamblese së Ortakëve**

Asambleja nuk përjashtohet nga e drejta e njohjes dhe e trajtimit të çdo problemi që ka të bëjë me shoqërinë dhe është në kompetencë të saj, të vlerësojë problemet për të cilat do të analizojë e do të vendosë pavarësisht se kujt organi janë kompetencë.

Për efekt evidentimi janë kompetencë ekskluzive të asamblese këto probleme:

- Miratimi dhe ndryshimi i statutit;
- Miratimi i llogarive vjetore dhe raportit të administrimit si dhe inventaret e shoqërisë;
- Emertimi dhe shkarkimi i administratoreve;
- Blerja kembimi dhe shitja e pasurive të paluajtshme si dhe të drejtave reale që lidhen me to;
- Dhenia e garancive në favor të tretëve;
- Marrja e huave;
- Pjëmarrja ose heqja dore nga shoqëri të tjera;
- Nenshkrimi i akteve të kompromiseve;
- Delegimi i kompetencave të caktuara.

## **Neni 20**

### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme**

1-Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit Nr 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithëshme .

2-Mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme thirret nepermjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike(email) drejtuar çdo ortaku,përfshirë dhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët.Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se nentëdhjë përqind të vlerës minimale të kuotave.Secilit ortak,se bashku me njoftimin e mbledhjes,i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

3-Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithëshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim,me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

## **Neni 21**

### **Mbledhjet e Asamblese së Përgjithëshme.**

1-Asambleja e përgjithëshme mer vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit Nr 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike,përfshirë telekonferencen(conference call),audio ose audio video, në përputhje me nenin 88 të ligjit Nr 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ortakët që marrin pjesë me mjete të komunikimit elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme.

2-Administratorët caktojnë kryetarin e mbledhjes si dhe një person për të mbajtur proces verbalin e saj.

3-Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si kryetar i mbledhjes

ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

4-Administratori,pamvarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesmarjes si edhe të marrë fjalën në cdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithëshme.

5-Kryetari,me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithëshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj mund (dhe është i detyruar nese kërkohet nga Asambleja e Përgjithëshme ) të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme , por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato ceshtje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparëshme.Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme shtyhet të paktën katermbëdhjetë ditë , njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vëndi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithëshëm i rendit të ditës.Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

6-Asmbleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet ne mënyrën e duhur një votim i fshehtë.Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose
2. Nje ortak ose ortakët që përfaësojnë të paktën pesë përqind të kapitalit themeltar të shoqërisë.Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka një vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

7-Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime,ose me një shumicë të caktuar,nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe rregjistrimi përkatës ne procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti,pa pasur nevojë për numërimin e votave të rregjistruara pro ose kundër vendimit.

8-Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë,do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

## **Neni 22**

### **Votat e ortakëve**

1- Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat,çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin ku është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ,të drejtën e një vote.

2- Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

3- Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit,vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.



## Neni 23

### Votimi me prokurë

- 1- Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku në formën që miratohet nga administratorët.
- 2- Në raste kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet në formën që miratohet nga administratorët.
- 3- Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vënd tjetër brenda territorit të republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- 4- Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronik (email) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti. Ky akt duhet të meret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

## Neni 24

### Hetime te posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit, paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

## Neni 25

### Administrimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet në veprimatrine e saj administratori, **Emiljano FETAHU për një periudhë 5 (pese) vjecare** nga momenti i themelimit në respektim të legjisllacionit perkates.

Administratori kryen gjate veprimatrise se tij ato detyra qe ai i gjykon te nevojshme qe jane ne interest te shoqerise per realizimin e objektivit te shoqerise dhe sigurimit te fitimit.

## Neni 26

### Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Përgjegjësitë

1. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithëshme;



2. Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në statut apo/dhe në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
3. Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.
4. Jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
5. Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
6. Te raportoje para Asamblesë së Përgjithshme sa herë që Asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
7. Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme;
8. T’i paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe të përgjigjet për to.
9. Të ushtrojë të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
10. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera në fuqi.

## **Neni 27**

### **Perfaqesimi i shoqerise**

Perfaqesimi i shoqerose i perket admistratroit te saj.

Administratori ngarkohet te perfaqesoj shoqerine ne lidhje me regjistrimin prane cilitdo organ tjeter shteteror per sa i takon nisjes se aktivitetit te saj. Gjithashtu, administratori eshte i ngarkuar te perfaqesoj shoqerine ne perftimin e licencave, patentave/markave tregtare. Dokumentat e nenshkruara prej tij per sa me siper shprehin vullnetin ortakeve duke perfaqesuar e Asamblesene e Ortakeve.

Shoqeria per probleme te vecanta mund te prokuroje persona te caktuar per ta perfaqesuar e per te vepruar vetem ne baze te prokures se posacme per problemin e caktuar.

## **Neni 28**

### **Mbarimi i Shoqerise**

Shoqeria mbaron dhe personi juridik pushon veprimtarine e tij ne keto raste:

1. Me vendim te mbledhjes se asamblese se Ortakeve ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkak.

2. Kur shoperia bashkohet me nje shoqeri tjeter ne kushtet ligjore te percaketuara.
3. Kur shoqeria falimenton.
4. Sipas shkaqeve të tjera të parashikuara nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare".

#### **Neni 29**

#### **Falimentimi dhe likuidimi i shoqerise**

Mbyllja e veprimtarise se shoqerise eshte kompetence e asamblese se ortakeve, e cila eshte e detyruar te analizoje gjendjen dhe per cdo rast percakton menyrate likuidimit te saj. Kur shoqeria eshte ne kushtet e likuidimit emri i saj detyrimisht pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper".

#### **Neni 30**

#### **Te ndryshme**

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

---

**Ky dokument perbehet nga 30 (tridhjete) nene ne 11 (njembedhjete) faqe**

---

**Ortakët e shoqerise "Security Solution & Distribution (SSD)" sh.p.k**

**Emiljano FETAHU**



**Migen KASAJ**

